



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGIJË**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



Prishtinë, 23 mars 2023  
Kodi i ZRRE: V\_1705\_2023

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,**

**Duke u bazuar në:**

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 Nenit 47 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 dhe Nenit 22 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat ligjore të Rregullës Nr. 03/2017 për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (Rregulla për Të Hyrat e OST/OT-së);
- Dispozitat e Rregullës Nr.10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë;
- Njoftimin e ZRRE Nr. 274/22 të datës 26.05.2022 për Procesin e Shqyrtimit të Tretë Tarifor; dhe
- Aplikacionin e Operatorit të Sistemit Transmetimit Operatori i Tregut (KOSTT SH.A) për të Hyrave të Lejuara Maksimale për Periudhën e Tretë Rregullative ( në tekstin e mëtejshëm: PRR3), të dorëzuar më datën 22 nëntor 2022;

**në seancën e mbajtur më 23 mars 2023 nxori këtë:**

**V E N D I M**

- I. APROVOHEN TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (në tekstin e mëtejshëm: HLM) që do të mblidhen nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – OST/OT (KOSTT SH.A.), për Periudhën e Tretë Rregullative PRR3 (2023-2027).**
- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale të OST/OT për Periudhën e Tretë Rregullative PRR3 (2023-2027) janë paraqitur në tabelën në vijim:**

<i>Të hyrat e Lejuara Maksimale për PRR3</i>	2023	2024	2025	2026	2027
	€000	€000	€000	€000	€000
HLM për OST/OT	55,234	61,056	61,449	61,561	62,098

- III. **OBLIGOHET** - Operatorit të Sistemit, Transmisionit, Operatori i Tregut (OST/OT) në përputhje me Metodologjinë e Përcaktimit Tarifave dhe Metodologjinë e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit, që të përgatisë dhe dorëzojë për aprovim në ZRRE tarifat e transmetimit, operimin e sistemit dhe operimin e tregut bazuar në HLM e OST/OT-së, sipas këtij Vendimi.
- IV. Ky vendim do të zbatohet nga Operatori i Sistemit të Transmisionit, Operatori i Tregut (OST/OT-KOSTT) duke filluar nga data 01 prill 2023.

### **ARSYETIM**

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 26 maj 2022 ka iniciuar Procesin e Shqyrtimit të Tretë Periodik për operatorët e rregulluar, duke përfshirë edhe Operatorin e Sistemit, të Transmisionit dhe Operatorin e Tregut (OST/OT).
- ZRRE sipas njoftimit të saj ka vlerësuar se ky proces i Shqyrtimit të Tretë Periodik për tarifat shumëvjeçare (PRR3) ka për qëllim për të vendosur të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) të të Licencuarve OST/OT dhe OSSH, për periudhën rregullative 2023-2027.
- ZRRE me datë 22 nëntor 2022 nga Operatori Sistemit të Transmetimit dhe Tregut – KOSTT SH.A ka pranuar aplikacionin për Hyrat e Lejuara Maksimal për PRR3 2023-2027.
- ZRRE pas vlerësimit fillestar të Aplikacioneve lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për të licencuarin e Operatorit të Sistemit, të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT, KOSTT), i licencuari dhe palët tjera të interesit kanë pasur mundësi t'i paraqesin komentet e tyre përmes konsultimit publik për periudhë dy javore.
- ZRRE më datë 16 shkurt 2023 ka publikuar Raportin Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale për OST/OT për PRR3.
- Raporti konsultativ ka paraqitur propozimet e ZRRE-së, për HLM që do të mbulohen nga OST/OT gjatë Periudhës së Tretë Rregullative PRR3. Të Hyrat e Lejuara Maksimale të miratuara do të përcaktojnë tarifat për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit, operimin e sistemit dhe operimin e tregut, të cilat do të ju ngarkohen shfrytëzuesve të Sistemit të Transmetimit. Raporti është vënë në diskutim publik me synimin që të marrë komentet e palëve të interesit për propozimet e ZRRE-së.
- Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut ka dorëzuar komentet me datë 03 mars 2023, ndaj Raportit Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike në kuadër të PRR3.
- ZRRE gjatë konsultimit publik, ka pranuar informata të përditësuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut, të cilat janë shqyrtuar dhe analizuar gjatë vlerësimit përfundimtar.
- ZRRE, ndër të tjera ka trajtuar të gjitha komentet e OST/OT lidhur me kostot e humbjeve në transmetim, shërbimet ndihmëse, Mekanizmin ITC, Fondin për BRE, shpenzimet operative, kostot

kapitale, komentet e KEK SH.A për ndryshimin e çmimit të energjisë për mbulimin e humbjeve në transmetim, si dhe komentet e palëve të interesit.

- Raporti Përfundimtar i Shqyrtimit të Hyrave të Lejuara Maksimale për OST/OT, përfshinë vlerësimet përfundimtare dhe përgjigjet në komente të palëve të interesit.
- Vlen të theksohet që të Hyrat e Lejuara Maksimale për OST/OT-në do t'i nënshtrohen procesit të Përshtatjeve të Rregullta Vjetore, sipas Rregullës Nr. 03/2017 për Të Hyrat e OST/OT-së, të nxjerr nga ZRRE.
- Gjithashtu duhet të theksohet se kostot e përgjithshme të KOSTT për vitin 2023 para përshtatjes së kostove të fondit të BRE-ve janë në vlerë prej 59,697€000s, por, pas përshtatjes për kostot e fondit të BRE-ve në vlerën prej 4,464€000s, kostot e përgjithshme të OST/OT për vitin 2023 janë 55,234€000s, ashtu siç është e definuar në dispozitiv të këtij Vendimi. Parashikimi i kostove të fondit të BRE-ve nga viti 2024-2027 ka marrë si vlerë bazë kostot e parashikuara në vitin 2023. Ngjashëm në vitet në vijim të periudhës rregullative kostot e fondit të BRE-ve do të përshtaten për të marrë parasysh dallimet ndërmjet parashikimit dhe realizimit.
- Bordi i ZRRE-së pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Ymer Fejzullahu, kryesues

  
Lutfije Dervishi, anëtar

  
Gani Buçaj, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KOSTT,
  - KEDS,
  - KESCO dhe
- Arkivit të ZRRE-së.